



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit te Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 1411/2019  
Nr./IqB/Br./Obl./M.Pg. 26/08/19



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIME

I

### MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS PËR VIZITËN NË QENDRËN EDUKATIVO - KORREKTUESE NË LIPJAN

Për: Z. Abelard Tahiri, Ministër  
Ministria e Drejtësisë

Z. Uran Ismaili, Ministër  
Ministria e Shëndetësisë

Z. Nehat Thaqi, Drejtor i Përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Milazim Gjocaj, Drejtor  
Departamenti i Shëndetësisë në Burgje

Z. Arif Beqa, Drejtor  
Qendra Edukativo - Korrektuese në Lipjan

Prishtinë, 26 gusht 2019

## HYRJE

Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejmë “MKPT”), bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t’i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, më 2 korrik 2019, e vizitoi Qendrën Edukativo - Korrektuese në Lipjan (në tekstin e mëtejmë “QEKL”).

MKPT-ja vërejti se Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria, përcaktojnë se duhet të themelohen ambiente të hapura paraburgimi për të miturit. Ambientet e hapura të paraburgimit janë pa masa sigurie, ose me masa sigurie minimale. Numri i të ndaluarve në këto ambiente paraburgimi duhet të jetë sa më i vogël, brenda mundësive.<sup>1</sup>

QEKL-ja zbaton shkallën e mesme dhe të ulët të sigurisë dhe të kontrollit, aq sa është e nevojshme për mbrojtjen e të miturve nga shkaktimi i vetëdëmtimeve apo shkaktimin e dëmit ndaj stafit apo të tjerve<sup>2</sup>. Kapaciteti i QEKL-së është 40 shtretër, ndërsa gjatë vizitës së realizuar nga MKPT-ja ishin të vendosur 15 të mitur të gjinisë mashkullore me masë edukuese.

Neni 29, paragrafi 1, i Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur thekson se gjykata e shqipton masën e dërgimit në një institucion edukativo-korrektues kur i mituri ka kryer vepër penale të dënueshme me burgim prej më shumë se tri (3) vjet dhe ka nevojë për edukim të specializuar, dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të të miturit. Paragrafi 4 i këtij neni parasheh se kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të zgjasë më pak se një (1) vit ose më shumë se pesë (5) vjet.

Qëllimi i masës edukative është që të kontribuojë në rehabilitimin dhe në zhvillimin adekuat të kryerësit, i cili është i mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste.<sup>3</sup>

Sipas Redit Shtëpiak të QEKL-së, organizimi i brendshëm ndërtimor dhe programatik i QEKL-së synon përbushjen e qëllimit rehabilitues për të miturit, duke pasur parasysh të drejtën e të miturit për privatësi, stimulim shqisor, mundësi për shoqërim me të miturit e tjere, edukim dhe arsimim të përgjithshëm dhe profesional, kujdes shëndetësor të duhur, ushqim sipas nevojave për moshën, pjesëmarrje në aktivitete sportive, argëtuese dhe kulturore.<sup>4</sup>

### **Qëllimi i vizitës**

Qëllimi i kësaj vizite ishte monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të mitur, të cilët gjenden në këtë qendër, të cilat parashihen me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, me ligjet

<sup>1</sup> Paragrafi 30 i Rregullave të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Cilëve u Është Hequr Liria. [http://www.unodc.org/pdf/criminal\\_justice/United\\_Nations\\_Rules\\_for\\_the\\_Protection\\_of\\_Juveniles\\_Deprived\\_of\\_their.Liberty.pdf](http://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/United_Nations_Rules_for_the_Protection_of_Juveniles_Deprived_of_their.Liberty.pdf)

<sup>2</sup> Neni 4, paragrafi 2, i Redit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së.

<sup>3</sup> Neni 22, i Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur.

<sup>4</sup> Neni 4, paragrafi 3, i Redit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së.

e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe me standartet ndërkombe të përmes raportit me rekomandime i publikuar më 7 shtator 2018.<sup>5</sup>

### Përbërja e grupit monitorues

1. Grupi monitorues përbëhet prej dy këshilltarëve ligjorë për parandalim të torturës dhe një këshilltare-punëtore sociale.

### Qendra Edukativo - Korrektuese në Lipjan

2. Neni 208 i LESP-së përcakton llojet e institacioneve korrektuese. Në grupin e këtyre institacioneve ligji në fjalë parasheh edhe institucionet edukative korrektuese për ekzekutimin e masave edukative të dërgimit në institucionin edukativo-korrektues të kryerësit i cili është i mitur.
3. QEKL-ja është institucion i tipit gjysmë të hapur dhe të hapur. Sipas LESP-së, institucionet korrektuese të tipit të hapur nuk kanë elemente të sigurisë fizike dhe materiale që e pengojnë arratisjen e personave të dënuar. Sjellja ndaj personave të dënuar bazohet në vetë disiplinën e tyre dhe përgjegjësinë personale, kurse personeli korrektues mbikëqyr lëvizjen dhe punën e personave të dënuar.<sup>6</sup>
4. Po ashtu, neni 6 i Rregullores (QRK) nr. 14/2016 për Themelin e Institacioneve Korrektuese për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në Republikën e Kosovës përcakton themelin e Qendrës Edukativo - Korrektuese në Lipjan, për ekzekutimin e masave edukuese, e cila është e tipit gjysmë të hapur dhe të hapur.
5. Neni 84, paragrafi 1, i Kodit nr. 06/L-006 të Drejtësisë për Mitur shprehimisht përcakton: “*Masa edukative e dërgimit në institucionin edukativ korrektohet në institucionin edukativ korrektohet të themeluar për këtë qëllim. Institucioni edukativo korrektohet është institucion korrektohet i tipit gjysmë të hapur dhe të hapur.*”

### Procedurat e pranimit në QEKL

6. Sipas nenit 5 të Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së, pranimi i të miturve në QEKL bëhet në pajtim me nenin 31 të LESP-së me këtë Rend Shtëpiak dhe përshtatshmërisht me Udhëzimin Administrativ për Pranimin e të Burgosurve dhe vendimin e drejtorit të përgjithshëm.
7. Menjëherë pas pranimit, i mituri i nënshtrohet kontrollit mjekësor nga personeli mjekësor brenda 24 orëve dhe përfshirët dosja mjekësore.<sup>7</sup> Pas pranimit, i mituri intervistohet nga punëtori social, i cili do të shërbet si menaxher rasti, dhe nga psikologu, të cilët hartojnë raportin me vlerësimin fillestare social dhe raportin me vlerësimin fillestare psikologjik.
8. Në objektin e QEKL-së gjendet zyra e pranimit, ku tash përfshirët, në mungesë të zyrtarit të pranimit, pranimin e të miturve e bën zyrtari ligjor. Në momentin e pranimit, të miturit informohen përfshirët Rendit Shtëpiak, përfshirët drejtësia e tyre.

<sup>5</sup><https://www.oik-rks.org/2018/09/07/raport-me-rekomandime-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalim-te-tortures-lidhur-me-viziten-ne-qendren-edukuese-korrektuese-ne-lipjan/>

<sup>6</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 209.

<sup>7</sup> Praktika Standarde e Veprimit, dokument i DShB-së, Procedurat përfshirët përfshirët herë të parë në burg-vizita e parë mjekësore.

## Bashkëpunimi i QEKL-së me MKPT-në gjatë vizitës

9. Gjatë vizitës nga MKPT-ja në QEKL, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (DShB) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan bisedat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues dhe pa praninë e personelit shëndetësor.

## Trajtimi i të miturve

10. MKPT-ja, gjatë vizitës në QEKL, zhvilloi intervista personale dhe grupore me një numër të konsiderueshëm të të miturve dhe nuk mori asnjë pohim për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike të ushtruar nga zyrtarët korrektues apo për sjellje të zyrtarëve e cila do të përbënte shkelje të dinjitetit të njeriut. MKPT-ja vërejti se ekziston një klimë shumë pozitive e marrëdhënieve dhe komunikim i mirë interaktiv ndërmjet të miturve dhe zyrtarëve korrektues.

11. Zyrtarët korrektues në QEKL nuk bartin uniforma dhe MKPT-ja vëren se Komiteti për Parandalim të Torturës (KPT), në standardet e përcaktuara për të miturit e privuar nga liria, inkurajon praktika të tilla kur në ambiente të tilla zyrtarët korrektues nuk bartin uniforma.<sup>8</sup>

## Kushtet materiale

12. MKPT-ja vërejti se dhomat ku qëndronin të miturit, sa i përket madhësisë dhe ndriçimit natyral dhe artificial, janë në pajtim me standardet e përcaktuara nga KPT-ja dhe LESP-ja.<sup>9</sup> Dhomat posedojnë dushe, tualete dhe dollapë, të cilët janë të mjaftueshëm për t'i vendosur gjësendet e tyre. MKPT-ja konsideron se në përgjithësi kushtet fizike në QEKL shkojnë përtëj standardeve minimale dhe arrijnë nivelin e standardeve të dëshirueshme për akomodim të të miturve me masën edukuese.

## Ushqimi

13. MKPT-ja vëren se LESP-ja përcakton se i dënuari ka të drejtë për ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tij, në tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të janë të llojullojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, për aq sa është e mundur, kërkësave të tij fetare dhe kulturore. Po ashtu, ky ligj përcakton obligimin që të dënuarit t'i sigurohet ushqimi i caktuar nga mjeku.<sup>10</sup>

14. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria, theksojnë se çdo ambient paraburgimi duhet të garantojë që çdo i mitur të marrë ushqim të përgatitur në mënyrë të përshtatshme dhe i cili u shërbeshet në vakte normale të ushqimit, me atë cilësi dhe sasi që i plotëson standardet e dietës, të higjenës, të shëndetit

<sup>8</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, pjesë nga raporti i 24-të i Përgjithshëm i KPT-së, publikuar në vitin 2015. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ccb96>.

<sup>9</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 36, paragrafi 2.

<sup>10</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 39, paragrafët 1 dhe 2.

dhe, për aq sa është e mundur, t'i plotësojë kërkesat fetare dhe kulturore. Çdo i mitur duhet të ketë ujë të pijshëm të pastër në çdo kohë.

15. Gjatë vizitës në QEKL, MKPT-ja u informua se ushqimi për të miturit në QEKL ende përgatitet në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan (QPL). Sipas njoftimit nga drejtori, punët në rinovimin e kuzhinës janë në fazën përfundimtare. Me të përfunduar punët, ushqimi do të përgatitet në kuzhinën e QEKL-së, e cila është pajisur me makineritë e nevojshme për përgatitje të ushqimit. MKPT-ja vizitoi kuzhinën dhe vërejti se punimet janë në përfundim e sipër dhe kuzhina është e pajisur me makineritë e nevojshme për përgatitjen e ushqimit për të miturit. MKPT-ja ka kërkuar nga drejtori i QEKL-së që ta njoftojë zyrtarisht kur të përfundojnë punimet në renovimin e kuzhinës.
16. Të miturit u shprehen të pakënaqur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit. Drejtori është i vetëdijshëm për këto pakënaqësi dhe synon ta përmirësojë kualitetin e ushqimit kur ta vejnë në funksion kuzhinën në QEKL.
17. MKPT-ja, përmes raportit me rekomandime, të publikuar më 7 shtator 2018, u ka rekomanduar autoritetet kompetente që t'i ndërmarrin veprimet në mënyrë që: “Ushqimi për të miturit të jetë i bollshëm dhe i përshtatshëm sipas kalorive të kërkuar për rritjen dhe zhvillimin e të miturve.” MKPT-ja vlerëson progresin e shënuar nga autoritetet kompetente në zbatimin e këtij rekomandimi dhe inkurajon autoritetet që të punojnë për ta zbatuar këtë rekomandim në tërsi.

### Regjimi

18. Sipas Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së, të miturit kanë qasje dhe u lejohet t'i frekuentojnë ambientet e jashtme për ajrim apo për aktivitete sportive sipas orarit të përcaktuar nga drejtori i QEKL-së, i cili nuk është më i shkurtë se 3 orë në ditë. Të miturit, të cilët janë nën masën disiplinore të veçimit, kryejnë shëtitjen në ambient të hapur, të veçuar nga të miturit e tjera, sipas orarit të përcaktuar enkas për ta.
19. Gjatë vizitës në QEKL, MKPT-ja u njoftua nga të miturit se ata lëvizin lirshëm në hapësirat e objektit të QEKL-së dhe u mundësohet shëtitja jo më pak se 3 orë, gjë që është në pajtim me nenin 86 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.<sup>11</sup> Qendra Edukativo - Korrektuese në Lipjan e ka kabinetin e informatikës të pajisur me kompjuterë, bibliotekën e cila është e pasuruar me disa tituj të ndryshëm, romane, kabinetin e shtypshkronjës, gjithashtu të pajisur me makineri adekuate për shtypjen e dizajnjëve në bluza, gota etj. Po ashtu, QEKL-ja e ka sallën e rrobaqepësisë dhe të floktarisë, të cilat janë të pajisura me mjete adekuate të punës.
20. Gjatë këtij viti, në QEKL u organizuan trajnime për ujësjellës, elektricist, murator, trajnim për përdorim të kompjuterit, ushtrime për prerje të flokëve, kursi i gjuhës angleze etj. Nga dokumentacioni i pranuar nga QEKL-ja, shihet se një OJQ<sup>12</sup> ka organizuar 12 seanca me të miturit, ku janë trajtuar tema të ndryshme ngajeta e përditshme. CARITAS KOSOVA ka mundësuar organizim të art terapisë dhe të teatër terapisë për të miturit, është organizuar një koncert muzikor dhe po vazhdon programi EQUIP.

<sup>11</sup> Neni 102, paragrafi 3, i Kodit të Drejtësisë për të Mitur thekson se i mituri ka të drejtë të kalojë të paktën tri (3) orë gjatë ditës në ambient të hapur brenda institucionit.

<sup>12</sup> Këto seanca diskutimesh me të miturit janë organizuar nga OJQ “Arra”.

21. Megjithatë, është për keqardhje që, në mungesë të trajnerëve adekuatë, kabinetet në dispozicion, përveç kabinetit të informatikës dhe floktarisë, ende nuk shfrytëzohen sa duhet.
22. Sipas drejtorit, planifikohet angazhimi i të dënuarve të cilët mund të ndihmojnë në aktivizimin e disa kabinetave që i ka QEKL-ja dhe të ofrohen aktivitetet konkrete për të miturit.
23. Përmes raportit me rekomandime, i publikuar më 7 shtator 2018, MKPT-ja u rekomandoi autoriteteve kompetente që: “**Të shtohen aktivitetet për të miturit dhe të funksionalizohen kabinetet ekzistuese dhe të angazhohen instruktorët adekuatë.**” MKPT-ja vlerëson lart përpjekjet e drejtorit për ta zbatuar këtë rekomandim dhe progresin e bërë në këtë drejtim. Gjithashtu konstaton se situata nuk ka ndryshuar aq sa është e nevojshme, në mënyrë që të aktivizohen të gjitha kabinetet e QEKL-së që janë në dispozicion.
24. MKPT-ja vëren se disa të mitur të akomoduar në QEKL u dërguan në teatër. Po ashtu u organizuan vizita në komplekse memoriale, ndërsa planifikohet realizimi i disa vizitave të tjera në institucione, parqe turistike dhe komplekse memoriale.
25. QEKL-ja e ka edhe sallën e sportit, e cila është moderne dhe e kompletuar me pajisje të nevojshme për lojën e futbollit dhe të basketbollit, si dhe sallën për fitnes, e cila është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme. MKPT-ja, gjatë vizitës, vërejti se sala e sportit dhe e fitnesit shfrytëzohen nga të miturit, çdo ditë nga një orë.
26. MKPT-ja vërejti se numri i aktiviteteve, i trajnimeve dhe i kurseve në QEKL, gjatë këtij viti, është rritur dukshëm krahasuar me vitin e kaluar. Prandaj, MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente e kanë implementuar rekomandimin sa i përket rritjes së numrit të aktiviteteve dhe të trajnimeve për të miturit në QEKL.

### Kontakti me botën e jashtme

27. MKPT-ja konsideron se kontaktet me botën e jashtme, veçanërisht vizitat nga familja apo të afërmit e tjerë, janë të rëndësisë thelbësore në kontekstin e rehabilitimit social të të burgosurve.
28. Neni 88, paragrafi 1, i Kodit të Drejtësisë për të Mitur përcakton se i mituri ka të drejtë të vizitohet nga prindi i tij; prindi adoptues, kujdestari, bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar dhe nga të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt, së paku një (1) herë në javë, minimum deri në një (1) orë. Ndërsa parografi 2 përcakton se i mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në muaj nga persona të tjerë, të cilët nuk ndikojnë negativisht në ekzekutimin e masës.
29. Sipas pohimeve të drejtorit dhe të të miturve, atyre u lejohet një vizitë gjatë javës dhe një vizitë shtesë nëse ata parashtronë kërkesë tek drejtori i QEKL-së. Përveç kësaj, në dispozicion të të miturve janë edhe telefonatat për të cilat QEKL-ja ua siguron kartelat për të telefonuar. Telefonatat nuk kufizohen nga drejtori, të miturit mund të bëjnë telefonata sa herë që ata duan. MKPT-ja përshtendet fillimin e zbatimit të kontakteve me botën e jashtme përmes programit SKYPE.
30. Për më shumë, MKPT-ja vërejti synimet tek drejtori që në QEKL të shtohet numri i vizitave familjare, të miturve t'u mundësohen dalje jashtë QEKL-së së bashku me

prindërit e tyre etj. MKPT-ja mirëpret këto plane duke pasur parasysh se regjimi në institucionë të tillë duhet të jetë i tillë që sa më pak t'i ngajë burgut.

31. Në këtë drejtim, MKPT-ja vëren se standardet e KPT-së, që kanë të bëjnë me kontaktet me botën e jashtme për të miturit e privuar nga liria, mund të janë referencë e mirë për autoritetet kompetente në synimet e tyre për të rritur beneficionet e të miturve sa u përket kontakteve me botën e jashtme.<sup>13</sup>

### Kujdesi shëndetësor

32. Neni 43 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë për shërbime shëndetësore pa pagesë. Personi i dënuar, të cilin nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues, dërgohet në spitalin e burgut, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjeter për përkujdesje shëndetësore. Po ashtu, kjo e drejtë për të miturin garantohet edhe me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.<sup>14</sup> Në kuadër të QEKL-së funksionon shërbimi mjekësor i përbërë nga një mjeke dhe një infermier.
33. Përveç kësaj, shërbimet mjekësore për të miturit mund të ofrohen nga njësitë shëndetësore në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, nga Qendra Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan dhe nga institucionet tjera publike shëndetësore. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga të miturit lidhur me shërbimet mjekësore të cilat u ofrohen në QEKL.

### Incidentet ndërmjet të miturve në QEKL

34. Bazuar në pohimet e drejtorit, në dokumentacionin e shqyrtuar dhe në pohimet e të miturve të intervistuar, incidentet ndërmjet të miturve nuk paraqiten të janë problem serioz për QEKL. Rastet e incidenteve ndërmjet të miturve në përgjithësi kanë të bëjnë me fjalosje, ndërsa gjatë këtij viti janë regjistruar dy raste të përleshjeve fizike, për të cilat drejtori ka ndërmarrë masa për parandalimin e përkeqësimit të mëtejmë të konfliktit dhe ka shqiptuar masat disiplinore në pajtim me legjislacionin në fuqi. Incidentet janë regjistruar në dokumentacionin adekuat administrativ dhe mjekësor.

### Masat disiplinore

35. Sipas LESP-së, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vëtmia<sup>15</sup>. Kurse në rastin e të paraburgosurve mund të shqiptohen dënimet si në vijim: kufizimi apo ndalimi i vizitave apo i korrespodencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, me Avokatin e Popullit dhe me misionet diplomatike.
36. Neni 90, paragrafi 1, i Kodit të Drejtësisë për të Mitur përcakton se dispozitat për procedurat disiplinore dhe për dënimet të zbatueshme për personat e dënuar me burgim, të parapara në LESP, zbatohen përshtatshmërisht për të miturin i cili i nënshtrohet masës së dërgimit në institucionin edukativo korrektues. Më tej, në nenin 90, paragrafi 2, shprehimisht theksohet: “Të miturit nuk i shqiptohet izolimi në qeli të veçantë si dënim disiplinor.”

<sup>13</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, pjesë nga raporti i 24-të i Përgjithshëm i KPT-së, pjesa kontaktet me botën e jashtme, publikuar në vitin 2015. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ccb96>.

<sup>14</sup> Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, neni 105, pika 1.6.

<sup>15</sup> Paragrafet nga 101 deri në 113 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

37. Neni 42, paragrafi 2, i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së thekson se masat disiplinore që mund t'u shqiptohen të miturve në QEKL janë: përjashtimi nga veprimitari të veçanta, të përbashkëta deri në 3 ditë, përjashtimi nga dalja në ambientet e jashtme në grup për jo më shumë se 5 ditë, përjashtimi nga të gjitha veprimitaritë e përbashkëta deri në 10 ditë.
38. Sa i përket masës disiplinore të vëtmisë, nenı 42, paragrafi 7, i Rendit të Brendshëm Shtëpiak të QEKL-së shprehimisht përcakton se ndalohet vëtmia si masë disiplinore ndaj të miturve, ndërsa veçimi për qëllime disiplinore vendoset vetëm në raste përjashtuese kur sanksionet e tjera nuk kanë qenë efektive. Ky veçim vendoset për një periudhë të përcaktuar kohore, e cila nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë.
39. Regjimi gatë këtij veçimi duhet të garantojë vazhdimin e programit arsimor, atij të formimit profesional, të punësimit, të kontakteve njerëzore, të materialeve për lexim dhe të sigurojë të paktën një orë dalje në ambientet e jashtme për ajrim apo për aktivitet fizik individual, çdo ditë, nëse e lejojnë kushtet atmosferike. MKPT-ja u njoftu nga drejtori se gjatë këtij viti nuk ka pasur raste kur është aplikuar masa disiplinore e veçimit.

#### **Procedura e parashtrimit të ankesave**

40. Neni 95 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur shprehimisht përcakton: “*Dispozitat e Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale lidhur me dorëzimin e ankesave dhe lutjeve nga personat e dënuar me burgim, vlejnë përshtatshmërisht për dorëzimin e ankesave dhe lutjeve nga të miturit ndaj të cilëve janë duke u ekzekutuar masa edukative – korrektuese, apo dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm shëndetësor.*”
41. Neni 91 i LESP-së përcakton në hollësi procedurën, sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që anksa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe ministri i Drejtësisë.<sup>16</sup>
42. MKPT-ja vërejti se në dispozicion të të miturve në QEKL gjenden kutitë e ankesave dhe të kërkësave, të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe ato të DShB-së. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.
43. Po ashtu, ata mund t'i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe përmes linjës telefonike pa pagesë (informatat për linjën telefonike janë të vendosura në kutitë e ankesave), përmes postës së rregullt, e cila, sipas LESP-së, nuk i nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre.
44. Për më shumë, QEKL-ja mund të vizitohet edhe nga organizatat ndërkombëtare dhe nga ato joqeveritare vendore.

<sup>16</sup> Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: “*Në ankimin e paraqitur, drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën e shkruar.*”

45. MKPT-ja vërejti se Drejtoria e QEKL-së ofron mundësinë adekuate për parashtrim të ankesave dhe të kërkesave, i shqyrton ato dhe u dërgon përgjigje të miturve në këtë qendër, në pajtim me LESP-së. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të miturit, sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

## REKOMANDON

Ministrisë së Drejtësisë:

- MKPT-ja ripërsërit rekmandimin që ushqimi për të miturit të jetë i bollshëm dhe i përshtatshëm, sipas kalorive të këruara për rritjen dhe zhvillimin e të miturve.
- Të funksionalizohen kabinetet të cilat ende nuk janë funksionale.
- Të angazhohen trajnerët adekuatë për punë në këto kabinete.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Cdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e këruara në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekmandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshire edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit